

VENDIM
Nr. 451, datë 18.4.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ZALL-DARDHË TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Zall-Dardhë të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zall-Dardhë të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr. 204, datë 21.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Zall-Dardhë të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Zall-Dardhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Zall-Dardhë		Lidhja nr. 1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Prona që përdoren për realizimin e funksionit në fushën e arsimit	Në pronësi
7	Prona që përdoren për realizimin e funksionit në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
9-12	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
13-31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e funeralit	Në pronësi
8,32,33,34,36,37,39,40,41,42, 44,45,47,48,49,51,52,53,55,56, 57,59,60,62,63,64,65	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësi-ushqimit (toka produktive)	Në përdorim Nuk transferohen sipërfaqet e trajtuara me VKM nr. 868, datë 18.6.2008
35,38,43,46,50,54,58, 61,66	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësi-ushqimit (toka joproduktive dhe ujtitje kullim)	Në pronësi
97-118	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e infrastrukturës rrugore	Në pronësi